



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:026486

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06230978

C-IV-14-2997

Ankuesi

G H fshati M, Podujevë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 30 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. PRN046-1015, datë 24 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN046-1015, datë 24 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të pasaktësuar nga NSH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim). Ankuesi theksoi se ka parashtruar kërkesën në AL me 29 tetor 2013, me nr. PRN046-1015 Zyra Rajonale në Prishtinë, për dëmshpërblimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën e pacaktuar. Mirëpo, AL i emëruar nga AKP me vendim e refuzon kërkesën e tij si të pavlefshme, duke u mbështetur në arsyet e mëposhtme: neni 35.3 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP parashikon që: “*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit të pronësisë: kërkesa apo*

pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme". AL për bazë merr se punëtori nuk ka kërkuar me kohë dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të pacaktuar. Ankuesi theksoi më tej se ka qenë punëtor aktiv i NSH deri në vitin 2003, ku edhe i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës. Pasi e ka kuptuar se një e drejtë e tillë i takon edhe atij me kërkesë iu ka drejtuar AKP-së për të realizuar të drejtën në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të pacaktuar. Mirëpo, AKP-ja me datë 25 mars 2014 kërkesën e tij e ka refuzuar si të pasafatshme. Ankuesi më tej pohon se nuk ka qenë i informuar se deri kur është afati për një kërkesë të tillë dhe kërkesën e tij e ka dorëzuar me datë 29 tetor 2013, pasi NSH-ja është në likuidim mendon se i takon kjo e drejtë në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nga mjetet e fituara nga procesi i likuidimit. Ankuesi shton se këtu shihet fakti se AL nuk i ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-034, ku mjaftë mirë precizohet kompensimi i dëmit që iu shkaktohet punëtorëve deri në momentin e fillimit të procesit të likuidimit dhe kjo e drejtë parashihet edhe në ligjin e punës së Republikës së Kosovës duke u bazuar në dispozitat e ligjit nr. 04/L-034 dhe Ligjit të punës që të mbrohet e drejta e punëtorëve. Ankuesi i propozon gjykatës që të aprovohet ankesa e tij dhe t'i njihet e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të pacaktuar nga NSH dhe të anulohet vendimi nr. 2933/2014 datë 25 mars 2014. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur vetëm vendimin e kundërshtuar.

Me 24 korrik 2024, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin ku kërkoi nga i njëjti që ndër të tjera të dorëzoj dëshmi relevantë në mbështetje të ankesës së tij. Me 30 korrik 2024, urdhri u pranua nga vajza e tij mirëpo asnjë përgjigje nuk u dorëzua.

Me 24 shtator 2024, e paditura AKP në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, Neni 31 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. E paditura thekson rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit pala kërkuese (parashtruesi) ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK-së dhe Neni 31 i Ligjit 06/L-086). Një rregull i tillë është shprehimisht i paraparë edhe në nenin 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. E paditura më tej thekson se ankesa është refuzuar pasi kërkesa tek AL është paraqitur me 29 tetor 2013 që është pas afatit për parashtrimin e kërkesave në likuidim (25 tetor 2013). Bazuar në deklaratën e ofruar nga parashtruesi tek AL arsyeja për parashtrim të vonuar është se parashtruesi nuk ishte në dijeni që NSH kishte hyrë në proces likuidimi. AL konsideron që arsyetimi për parashtrim të vonuar nuk është bindës, për shkak se parashtruesi ishte i informuar në mënyrën e duhur me të gjitha njoftimet e mundshme përfshirë afatet e zbatueshme për kërkesat ndaj NSH. Për më tepër, dy emetime publike janë publikuar në gazetën kombëtare "Koha Ditore" për të informuar të gjitha palët e interesuara lidhur me fillimin e procesit të likuidimit të NSH-së. Të obliguar nga neni 35.3 i Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në përcakton se AL mund të pranoj një kërkesë pas afatit për parashtrimin e kërkesave vetëm "*nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim*

të vonuar...”. Megjithatë, parashtruesi nuk ofroi arsye të justifikueshme për parashtrim të vonuar. Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në paragrafin më lartë, AL erdhi në përfundim që kërkesa për paga është e pavlefshme dhe për këtë arsye refuzohet. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086. E paditura në mbështetje të saj ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: vendimin e kundërshtuar, Formularin për parashtrimin e kërkesës jo – pronësore në likuidim 737/2013 datë 29 tetor 2013 dhe Vendimin për përbërjen / emërimin e anëtarëve të AL datë 4 gusht 2023.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Siç mund të konstatohet nga shkresat e lëndës, ankuesi nuk ka parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit tek AL, as në kohën e parashtrimin të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime/punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të pasaktësuar. Ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e kompensimit të kërkuar. Ankuesi ka dështuar që të precizoj ankesën e tij dhe të dorëzojë prova relevante në mbështetje të saj edhe pas urdhrin të përsëritur të gjykatës, duke zgjedhur që të mos përgjigjet.

Baza e kërkesës dhe numri i pagave të kërkuara në këtë procedurë si një kërkesë për kompensim për shkëputje të parakohshme të kontratës së punës duhet të mbështetet plotësisht me provat përkatëse për vitet e përvojës së punës në ndërmarrje ashtu siç parashihet me nenin 76.7 Ligjit nr. 03/L-212 i Punës. Kjo dispozitë zbatohet në këtë rast në kuptim të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP mbi bazën e të cilave edhe përcaktohet numri i pagave që mund të jepet për ish-punonjësit në rastet e largimit kolektiv nga puna.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të palëve në lidhje me objektin e kontestit, por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar